ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **205-23-1843-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9-Segmenti Kijevë-Dollc,Loti 1,2,3,4**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Grupi i Operatoreve Ekonomik "Sallahu Shpk & Salillari Shpk"**
NUI	**810135237**
Adresa	**Rr.Baki Dullovi, Nr.158**
Vendi	**Kaçanik**
Kodi postar	**71000**
Numri Telefonit	**049745000**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Lulzim Sallahu**
Adresa elektronike	**nntsh_sallahu@hotmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**10.01.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

LLOT 1 – St 0+670 - 4+000, L=3370 m[]LLOT 2 - St 4+000 - 7+050, L= 3050 m[]LOT3-St 7+050 - 10+200, L= 3150 m[]LLOT 4 - St 10+200 - 13+403, L=3203 m

08.03.2023 Njoftim per Kontrate

04.05.2023 Afati i fundit per dorezimin e tendereve dhe ofertimi

04.05.2023 Procesverbali I hapjes se tendereve

29.12.2023-Njoftim mbi vendimin e AK

03.01.2024- Kërkesë për qasje konform LPP-se

03.01.2024-Takimi per qasje ne dokumente sipas LPP

03.01.2024-Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/A të LPP-se

09.01.2024 Plotesim i Kerkeses per Rishqyrtim me deshmi shtese

09.01.2024 - Vendim mbi refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒ **Jo** ☐

Procesverbali i hapjes se tendereve eshte ngarkuar ne platformen elektronike e-prokurim dt 04.05.2023 , ku jane dorezuar 83 oferta nga operatore ekonomik te ndryshem per Lot 1,2,3,4.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me date 03.01.2024 kemi parashtruar Kerkese per Rishqyrtim per Lot 1 ,2 3, 4 prane Autoritetit Kontraktues

Me date 09.01.2024 kemi pranuar Vendimin e Autoritetit Kontraktues per Refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim

Ne pajtim me nenin 108/A parg 7 , nderlidhur me nenin 109 te LPP-se parashtrojme kete Ankese .

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qellimi
Neni 6- Ekonomiciteti dhe efiksasiteti
Neni 7- Barazia ne trajtim , jo diskriminimi
Neni 10 Mjetet per promovimin e transparences
Neni 11 -Informatat sekrete afarsite
Neni 59-Ekzaminimi vlersesimi dhe krahasimi I tendereve
Neni 60 - Kriteret per dhenien e kontrates
Neni 64- Deshmite e kerkesave
Neni 69-Aftesia teknike dhe profesionale
Rregullorja nr 01/2022 per Prokurim Publik
Udhezuesi nr 01/2023 per Prokurim Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me date 04.05.2023 Grupi Operatoreve Ekonomik Sallahu Shpk & Salillari Shpk kane dorezuar oferten per Lot 1,2,3,4 ne lidhje me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi I rruges Nacionale N9 segmenti Kijeve- Dollc, Loti 1 ,2,3,4" me nr.prokurimit 205-23-1843-5-1-1, ne perputhje me te gjitha kerkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues ne DT dhe

FDT.

Me kete rast konform Procesverbalit te Hapjes se tendereve, vlera e oferteve tona eshte rradhitur nder te te lirat sipas cmimit, ku Kriteri I Dhenies se Kontrates ka qene Tenderi I pergjegjshem ekonomikisht me I favorshem I percaktuar sipas peshes se nen kritereve te percaktuara ne Aneks 6 ,ku Cmimi ka pasur 60 % të poentimit, dhe 40% kerkesat e tjera teknike-profesionale . (Shih Procesverbali i Hapjes se Tendereve)

Dhe duke qenë se kemi ofruar shumefish kapacitete teknike dhe profesionale nga ato se cfare jane kerkuar , rrjedhimisht sipas nje llogaritje te drejte te poentimit,kemi konsideruar se jemi meritor per t'u shperblyer me ndonjerin nga Lot -et si Operatori i pergjegjshem me cmimin ekonomikisht me te favorshem.

Mirëpo, me date 29.12.2023 ne ora 14: 40 kemi pranuar Letren standard per tenderuesin e eliminuar , dhe Njoftimin mbi vendimin e AK-se me te cilin me kontrate rekomandon operatoret ekonomik te papergjegjshem si ne vijim :

Për Lot 1 : R&Rukolli; SABA BELCA Dega në Kosovë ;ELMAZAJ KONSTRUKSION; Tekno-Konstrukt SH.P.K

Për Lot 2 : OE Empreus Shpk, Jaha Company Shpk , Premium Ks, Tofior, NNT ABC, Metag Insaat Ticaret

Për Lot 3 : OE Lika Trade , Tofi DOO , Lika Company

Për Lot 4 : OE Famis Co Hc , KIT -AK , Kag Asphalt Company

Autoriteti Kontraktues, përkatësisht Komisioni Vleresues(p*er te cilin kemi dyshime se nuk ka qene kompetent*) ka perdorur arsyetim te pa bazuar dhe kunderligjor qe te na cilesoje si te pa pergjegjshem dhe te mos na rekomandoje me kontrate per ndonjerin nga Lot-et e ketij tenderi. Ne kete drejtim duke vepruar ne kundershtim me qellimin, ekonomicitetitn dhe efikasitetin te sanksionuar me Ligjin e Prokurimit Publik , dhe duke rekomanduar per kontrata operatore te pa pergjegjshem te cilet as per se afermi nuk plotesojne kerkesat e dosjes se tenderit, dhe me cmime ekonomikisht te pa favorshme ,duke demtuar keshtu edhe Buxhetin e Republikes se Kosoves qindra mijëra euro.

Te pakënaqur ndaj Vendimit te AK te dt 29.11.202 , duke qenë palë me interes në kuptim të nenit 4 të LPP-së paragrafi 1.11 lidhur me paragrafin 1.26, kemi paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së në përputhje me nenin 108/A të LPP-së , ku mbi bazen e provave dhe fakteve të ofruara mbi shkeljet procedurale dhe materiale të bëra ne kete aktivitet te prokurimit, kemi kërkuar që të anulohet Njoftimi per dhënie te kontrates I dt 29.12.2023 dhe lenda te kthehet ne rivleresim për Lot 1 , 2, 3, 4 dhe të shpallemi OE I pergjegjshem dhe I rekomanduar me ndonjerin nga Lot-et.. - (*Prove Kerkesa per Rishqyrtim dhe*

plotesimi me deshmit tjera shtese 03.01.2024)

Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë mundin që të shqyrtojë pretendimet tona krahas provave dhe fakteve të shumta që kemi ofruar fillimisht mbi pergjegjshmerine tone, dhe mbi parregullesite dhe shkeljet ligjore pergjate vleresimit te ketij tenderi, por i ka refuzuar si të pa bazuara duke mos ofruar asnjë arsyetim të argumentuar lidhur me pikat ankuese të Kërkesës për Rishqyrtim , që në fakt përbëjne bazë ligjore për ktkhim të lëndës në rivlerësim . (P*rovë : Vendimi mbi refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim 09.01.2024)* .

Andaj , pas udhëheqjes së procedurës paraprake për zgjidhjen e mosëmarrveshjeve , në kuptim të nenit 109 të LPP-së i drejtohemi Organit Shqyrtues me këtë Ankesë kundër Vendimit mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim te dt 09.01.2023, duke kërkuar anulimin e Vendimit te Autoritetit Kontraktues , dhe pas shqyrtimit të provave dhe pretendimeve te parashtruar ndaj shkeljeve procedurale dhe materiale kerkojme vendosje meritore,dhe kthim të lëndës në Rivlerësim edhe për LOT 1, 2,3 dhe 4 .

Pretendimi 1

Permes Letres standard per tenderuesin e eliminuar ‘’Sallahu Shpk & Salillari Shpk ‘’ eliminohen nga procedura e prokurimit nen arsyetimin se :

OE Ka deshtuar te plotesoje kerkesat e percaktuara ne Njoftimin e Kontrates dhe DT i mungojne :

Ne Listen e Paisjeve eshte kerkuar Pika 10 Grejder 12-16t , jane kerkuar 3 Grejdera .Ndersa Operatori ka ofruar 5 Grejdera, 4 prej te cileve e tejkalojne kapacitetin e kerkuar :

1.Grejder me kapacitet <u>16.2t</u>

1Grejder me kapacitet 18t

1Grejder me kapacitet 17t

1Grejder me kapacitet 20t

Paisja me nr 1 Greder marka O&K, tip F156.6A 2004, nr.107174 nga kerkimet ne interenet verifikohet se ky grader ka peshe prej 16,200kg ashtu siq eshte prezantuar nga vet operatori ekonomik nepermjet DUD-it.

Paisja nr.2 Greder Catepillar Champion 740,1990 eshte sipas kerkesave te DT-se.

Paisja nr.3 Grejder O&K tip 106 A ,viti 1992 , ne DUD nuk prezantohet pesha e paisjes mirepo pas kerkimit ne internet vertetohet se kjo paisje eshte nen peshen 12t, me c' rast nuk eshte ne perputhje me kerkesat e DT.

Paisja nr. 4 Greider Caterpillar 120m, viti 2018 me targa AKTM 67 . Ne dokumentacionin e prezantuar per kete paisje mungon pesha e paisjes. Mirepo pas kerkimit ne internet vertetohet se kjo paisje eshte 16,900 kg, me c'rast nuk eshte ne perputhje me kerkesat e DT-se , Lot 2, Lot 3 dhe Lot 4 , OE eshte I pa pergjegjshesm pasi nuk arrin te plotesoje kerkesat e percaktuara ne DT .

Sqarojmë se :

Sipas Letres standard per tenderuesin e eliminuar, Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur qe te argumentoje se OE Sallahu & Salillari jane operatore ekonomik I pa pergjegjshem .

Vecanarisht per Lot 1 nuk kemi pranuar asnje arsyetim eliminimi, per faktin se referuar Listes se paisjeve te Lot 1 , ne **piken 10 eshte kerkuar Grejder 12 -16 ton 2 cope dhe ne Lot** 2 , 3 , 4 jane kerkuar **Grejder 12-16 t (3 cope) .**

<u>Meqë nuk janë trajtuar provat e ofruara lidhur me kete pretendim nga Autoriteti Kontraktues , kerkojme nga OSHP qe t'a trajtoje, dhe ne baze te provave si ne vijim te ne kualifikoje si operatore ekonomik i pergjegjshem per Lot 1,2,3,4 .</u>

OE Sallahu Shpk & Salillari Shpk ka ofruar 5 Grejder , ku 3 prej tyre e plotesojne kapacitetin e kerkuar prej 12-16t, dhe jane te renditur ne Listen e paisjeve si ne vijim, si dhe dy Grejder te tjere shtese ku nga deshmite e ofruara provohet qarte se jemi te pergjegjshem ne te 4 Lotet.

10.	Grejder 12-16t	2	5	1.Greder marka O & K , tip F 156.6A , viti i prodhimit 2004 , nr. 107574

Salillari

				2. Greder Cate tip Champion 740 , viti i prodhimit 1990 3. Greder marka O & K , tip 106A, viti i prodhimit 1992 4. Greder , marka caterpillar 120m, viti i prodhimit 2018 , targat AKMT67 5. Greder , marka Caterpillar, tip 14 G, viti i prodhimit 2003

-Greder I renditur nr. 1 Marka O & K tip F156.6A, viti I prodhimit 2004 , nr. 107574 , me kapacitet 16 ton e 200kg eshte konform kerkeses se vendosur nga Autoriteti Kontraktues dhe nuk paraqet tejkalim te kapacitetit sepse eshte 16 ton, dhe 200 kg me teper natyrisht se nuk ndikojne asgje ne kryerjen e funksionit dhe cilesise se tij, per faktin se edhe nga vet prodhuesi shume prej paisjeve nuk e kane te fiksuar kapacitetin prej vetem 16t.

Ne kete rast, duhet te merret si devijim I vogel ne raport me qellimin e aktivitetit te prokurimit , dhe ekonomicitetit konform nenit 59 par 4 i LPP-se , ashtu sic thuhet edhe ne Vendimin nr 0397/2023 te OSHP-se lidhur me nje arsyim te tille te eliminimit ne nje tjeter AP.

Sepse ne rastin konkret per Lot 1 Oferta e OE R&Rukolli eshte prej 233,128.00 euro me e shtrenjte se oferta e OE Sallahu dhe Salillari, e po ashtu edhe per Lot 3 Oferta e OE Lika Trade eshte 110,636.0 euro me e shtrenjte se oferta e OE Sallahu dhe Salillari.

Sikurse e percakton LPP : devijime te vogla qe nuk mund te shkaktojne ndryshime materiale, ose devijime nga karakterisitikat, kushtet, dhe kerkesat e tjera te

parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe Dosjen e tenderit .
Ku nga praktika, ka raste kur MMPHI I ka kaluar pasije edhe me pesha me te medha.

Pra grederi ne fjale I pergjigjet plotesishte kerkeses se Autoritetit Kontraktues, dhe sipas Rregullores nr 01/2022 per Prokrim Publik eliminimi per nje ‘’arsye’’te tille tregon jo seriozitet dhe profesionalizem.

Ne perputhje me nenin 40 par 4 nderlidhur me nenin 40.7 te Rregullores nr 01/2022 per Prokurim Publik thuhet se :

Tenderi do te konsiderohet I pergjegjshem kur

a) Eshte ne pajtueshmeri ne nga aspketi administrative me kerkesat formale te Dosjes se Tenderit

b) Eshte ne pajtueshmeri me termet teknike , me pershkrimin, kerkesat dhe specifikimet e percaktuara te Dosjes se tenderit

c) Eshte dorezuar nga operatori ekonomk qe permbushe kriteret e perzgjedhjes te percaktuara ne Dosjen e Tenderit .

Ne "pajtueshmeri" nga aspekti administrativ dhe teknik duhet te kuptohet si permbushje e e kerkesave dhe specifikimeve administrative dhe teknike te parashtruara ne Dosje te Tenderit, duke mos u larguar ne menyre thelbesore nga ato dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime.
Largime dhe kufizime jane ato te cilat :

(i) Dallojne esencialisht nga kushtet dhe specifikimet e Dosjes se Tenderit, dhe /ose

(ii) Afektojne paramterat, cilesine ose ekzekutimin e kontrates , dhe/ose

(iii) Kufizon te drejten e AK ose obligimet e tenderuesit sipas kontrates, dhe ose

(iv) Shtremberon konkurrencen e tendereusve, ofertimet e te cileve jane ne pajtueshmeri me rregullat.

Se Autoriteti Kontraktues po perdore standarde te dyfishta te vleresimit dhe qe e demtojne edhe Buxhetin e Republikes se Kosoves e deshmon fakti se e rekomandon nje OE me te shtrenjte sesa ne prej 110,636.09 euro , me po te njejtat paisje sic I kemi ofruar ne ,dhe i cili ka ofruar pra 2 Greder 16.2ton(Lika Trade - Lot 3) , ndersa ne na eliminon se kemi ofru 1 greder te tille 16.2ton
Nga kjo duhet te nenkuptohet se edhe Grederi I ofruar nga Sallahu dhe Salillari duhet te jete I pranueshem per Autoritetin Kontraktues, dhe nuk do t'i shkaktoje humbje as Buxhetit te Republikes se Kosoves qindra mijera euro.

- **Greder me piken nr. 2 Cate Champion 740, viti 1990 me kapacitet 16t po ashtu eshte konform kerkeses se AK-se .**

- **Greder i renditur ne piken 3 Marka O & K tip 106 A , viti i prodhimit 1992 ka kapacitet 12t. Sikurse shihet nga deshmite te cilat kane qene te bashkangjitura me oferte dhe per njohesit e fushes, eshte i mjaftueshem vetem modeli i paisjes ne fjale per te kuptuar kapacitetin e saj, gjithesesi me nje kerkim te thjeshte ne internet , mund te verifikohet lehtesisht kapaciteti I modelit te paisjes ne fjale, pra Greder tip 106 A I cili ka 12t .**

Ne lidhje me rezultatin e kerkimit ne internet per Greder O& K F106 shfaqen fotografite me te dhenat tekike sikurse Grederi I ofruar ne piken 3 te Listes se paisjeve, me cka deshmohet edhe njehere se ''<u>OE Sallahu Shpk & Salillari Shpk'' eshte I pergjegjshem dhe ka plotesuar kerkesen nr 10 te Listes se paisjeve per Lot 1 , 2 , 3 dhe 4 .</u>

Se Grederi i renditur ne piken 3te Listes se paisjeve ka 12t, dhe ploteson kerkesen e DT , e deshmon edhe fakti se si <u>Autoriteti Kontraktues per Operatorin Granit Shpk , lidhur me nje Greder te paraqitur nga ky operatore me te dhenat ‘’ Greder Faun 105’’ thote se ka peshen 12,400kg dhe si I tille eshte I pranueshem ky grader.</u>

<u>Analogji me kete , si eshte e mundur qe Grederi F 106i Sallahu & Sallilari (pra grader me I madh) te jetë nën 12t , ndersa Grederi F 105(qe eshte me I vogel) te jetë mbi 12t.</u>

<u>Keto veprime , paraqesin qarte qasjen e pa barabarte dhe diskriminuese ndaj Operatorit Ekonomik Sallahu Shpk & Salillari.</u>

Sikurse u potencua me larte, nga GEO Sallahu & Salillari jane ofruar edhe Greder te tjere shtese (pika 4 dhe 5) te cilet po ashtu plotesojne kerkesat Minimale te vendosura nga Autoriteti Kontraktues sic eshte Grederi Caterpillar 120m viti I prodhimit 2018 I cili ka tonazhen prej <u>16 ton e 900 kg</u>, ku eshte ofruar nje paisje e re , prodhim I viteteve te fundit , dhe ne kete kuptim do te duhej te merrej si positive per realizim te projektit pasi qe nuk perben asnje ndryshim negative material te dosjes se tenderit, dhe do te duhej po ashtu te cilesohej si devijm I vogel.

OE Sallahu Shpk & Salillari ka ofruar edhe nje Greder tjeter Shtese Marka Caterpillar tip 14g viti I prodhimit 2003 .

Ne mbeshtetje te provave dhe fakteve te ofruara deshmohet se AK Komisioni Vleresues I ketij tenderi , ka vepruar ne kundershtim me nenin 59 te LPP-se duke na eliminuar nga procedura e prokurimit pavaresisht se eshte permbushur kerkesa ne fjale sic deshmohet edhe nga provat dhe argumentet e bashkangjitura, andaj bazuar ne qellimin,ekonomicitetin dhe efikastitetin e procedures, ne drejtim te ruajtjes se buxhetit , kerkojme nga OSHP qe te i konstatoje si devijime te vogla.

Pretendimi nr. 2

Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundershtim me nenin 40.3 te Rregullores nr 01/2022 per Prokurim Publik duke shkelur afatet ligjore te vleresimit te tenderit dhe nxjerrjes se njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Duke qene se afati i fundit per dorezimin e tendereve ka qene data 04.05.2023

Me datë 29.12.2023 eshte publikuar Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues .

Pra , Autoriteti Kontraktues nxjerre vendim per vleresim te tenderit pas 238 dite ne kundershtim me rregullat e prokurimit publik.
Perkatesisht , sipas Rregullores nr 01/2022 per Prokurim Publik , Neni 40.3 thuhet

"Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve."

Perderisa ne platformen elektronike e-prokurim nuk ka asnje njoftim per tejzgjatje te periudhes se vleresimit apo arsyetimin lidhur me shkeljen e afateve ligjore.

Po ashtu , Njoftimi i publikuar per rekomandim me kontrata te dt 29.12.2023 ne ora 14:40 minuta, pra kur kanë qenë 4 ditë pushimi/festa zyrtare në vazhdim , dhe afatet kohore per Kerkesen per Rishqyrtim fillojne te rrjedhin pavaresisht kesaj, këto veprime të Zyrës së Prokurimit konsiderojme se janë ne kundershtim me qellimin dhe parimet e prokurimit publik per transparence ne shfrytezimin e fondeve publike, ku keto veprime jane ndermarre per te "ngulfatur"transparencën, dhe per t'u pamundësuar operatoreve ekonomik njoftimin lidhur me procesin e vleresimit te tendereve(qe do te elaborohet ne pretendimin si me poshte) .

Pretendimi nr. 3

Duke qene se Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues eshte publikuar me date 29.12.2023 ne ora 14;40 nje ore para perfundimit te orarit te rregullt te punes, dhe duke qene se ne vazhdim kane qene 4 dite pushimi/festa zyrtare ne vazhdim, dita e Merkure dt 03.01.2023 ka mbetur dita e fundit per ‘’realizuar qasjen ‘’ ne dokumentet mbi te cilat eshte bere vleresimi dhe rekomandimi me kontrata ,ku po kete dite ka qenë edhe afati i fundit per te paraqitur Kerkesen per Rishqyrtim .

Te gjitha keto veprime ne drejtim te cenimit te transparences, jane ne kundershtim me Kodin Etik te Prokurimit Publik dhe dispozitat e detyrueshme, te ndermarra me qellim per t'i pamundesuar operatoreve ekonomik qasje ne dokumente , ku keto veprime shtojne edhe me teper dyshimet per shkelje dhe keqperdorime.

Grupi I Operatoreve Ekonomik Sallahu Shpk & Salillari me date 03.01.2023 ka parashtruar Kërkesë me shkrim për qasje në dokumente konform LPP-së drejtuar Zyrës së Prokurimit pranë MMPHI në platformën elektronike e-prokurim.

Dhe ne ora 12:00 na eshte mundesuar qasje ne dokumentacion, qasje te cilen e konsiderojme te pjesshme sepse ne lidhje me Operatorin Ekonomik te rekomanduar per Për Lot 2 : OE Empreus Shpk, Jaha Company Shpk , Premium Ks, Tofior, NNT ABC, Metag Insaat Ticaret nuk na jane ofruar dokumentet bazike mbi te cilat eshte bere vleresimi dhe rekomandimi me kontrate , ku pa asnje Vendim per klasifikim te dokumenteve nga Autoriteti Kontraktues jane fshehur të gjitha dokumentet mbi kapacitetin teknik,financiar dhe profesional, dhe dokumente te tjera te cilat nuk jane kerkuar fare te jene si sekret afarist perfshire edhe Formularin e Dorezimit te Tendereve.

Ne baze te nenit 11 par 3 te LPP-se thuhet se Autoritetet Kontraktuese mund te i klasifikoje informatat e tjera si secrete afarsite vetem nese informata perkatese i permbushe keto tri kritere :

3.1 qe ate ta kete derguar nje operatore ekonomik ne perputhje me kerkesen e percaktuar nga Autoriteti i tille kontraktues sipas nenit 68 ose 69 te ketij ligji
3.2 qe operatori perkates ekonomik t'I kete derguar Autoritetit Kontraktues kerkesen me shkrim duke shprehur deshiren e tij qe Autoriteti Kontraktues t'I mbaje artikujt e tille si sekret , dhe
3.3 kerkesa e tille me shkrim te permbaje nje deklarate me shkrim (i) ne te cilen vertetohet se nje element I tille nuk eshte prone publike, dhe se te dhenat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qellimshem apo nga pakujdesia dhe (ii) me te cilen parashtrohen arsyet qe bindshem demonstrojne , sipas gjykimit te arsyeshem te autoritetit kontraktues se qasja publike ne lementin e tille do te rezultonte ne demtim material te interesave legjitime komerciale te operatorit te tille ekonomik.

AK nuk na ka ofruar qasje ne dokumente te operatorit te rekomanduar per LOT 2 ne kundershtim me nenin 10 dhe 11 te LPP-se duke fshehur dokumentet bazuar ne nje "Kerkese per Sekret afarsit " te OE e cila nuk I permbushe fare kushtet ligjre sic percaktohet me par 3 te nenit 11 te LPP=se/
Sipas nenit 7.6 par 3 te Rregullores nr 01/2022 per Prokrurim Publik thuhet se '' duhet dhene arsyetimet per secilin document te identifikuar si sekret afarsist' ' .

Ne Kerkesen per Sekret Afarsit nuk eshte ofruar asnje arsye qe bindshem do te demonstroje se qasja ne dokumente publike do te rezultonte ne demtim material te interesave legjitime komerciale te operatorit ekonomik.
Operatori Ekonomik nuk ka vertetuar se nje element I tille nuk eshte prone publike, kushte keto te cilaat percaktohen shprehimisht me par 3.3 te nenit 11 te LPP-se .

Pra, kerkese per sekret afarsist (dhe fshehje te dokumenteve) eshte bere edhe per dokumente qe ne fakt cilesohen si prone publike , sic jane psh Kontratat Publike me liste te Kontratave te cilat operatori fitues I ka te lidhura me insitituciont publike , pra

deshmohet se jane fsheur dokumente ne menyre te kunderligjshme , shto ketu faktin se Kontratat e realizuara ne 3 vitete e fundit kane qene edhe nje nder kriteret e dhenies se kontrates me pike poentimi , pamundesia e qasjes se keto dokumente
te cilat ligjerisht do te duhej te kishim qasje , paraqet qartazi shkelje te nenit 10 dhe 11 te LPP-se, dhe shton edhe me teper dyshimet se OE I rekomanduar nuk e ka plotesuar kete kerkese.
Cdo kontrate e lidhur me institucionet publike , ne kete rast Autoritetet Kontraktuese ka titullin KONTRATE PUBLIKE ,dhe eshte prone publike.

Numri i Prokurimit: *205 23 1843 511*– Titulli : Zgjerimi i rrugës nacionale N5-Segmenti Kijevë-Dollc, Loti 1,2,3,4

Aneksi 3 KËRKESA PËR SEKRET AFARIST

Për: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**
(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE ***EMPREUS SH.P.K*** (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara:

1. KAPACITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR.
2. KAPACITETIN TEKNIK DHE PROFESIONAL.
3.LISTA E KONTRATAVE (KONTRATAT, REFERENCAT, RAPORTET PERFUNDIMTARE).
4. LISTA E PUNETOREVE (DESHMIT E MARRA NGA ATK).

5. LISTA E PAISJEVE AKTI (DOKUMENTACIONI I PAISJEVE, DUDE DOGANORE, FATURE, LIBREZE QARKULLIMI).
6. PARAMASA DHE PARALLOGARIA.

7. MBESHTETJA BANKARE E DORZUAR

8. LISTA E ING-VE DHE GJITHË DOKUMENTACIONI I ING-VE

9. MARRVESHJET E DOREZUARA

Të nenit 69 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

Deklaratë mbi natyrën e dëmit të tillë material dhe arsyet pse do të duhej të shfaqet:

Me respekt kërkojmë që dokumentacioni i lartëpërmendur i dorëzuar me këtë ofertë të mbahet konfidencial, pasi zbulimi i tyre publik do të shkaktonte dëme të konsiderueshme tregtare për kompaninë tonë. Ne e kuptojmë se ky informacion mund të duhet të ndahet me zyrtarët përkatës të Autoritetit Kontraktues për qëllime të vlerësimit të kësaj oferte, por kërkojmë që ai të trajtohet si pronë e kompanisë dhe të mos vihet në dispozicion të publikut ose palëve të tjera të treta.

Zbulimi i dokumenteve të tilla mund të zbulojë sekrete tregtare dhe informacione pronësore që kompania jonë nuk do të dëshironte të bëheshin

Po ashtu, jane fshehur edhe dokumente te cilat ne asnje menyre dhe rrethane nuk demtojne interesat biznesore sic jane stafi I prezaantuar , pasijet e ofruara per realizim te projektit , pastaj FORMULARI I DOREZIMIT TE TENDERIT, qe nuk eshte fshehur asnjehere ,

ofrojne arsye te bindshme se AK ka kufizuar qasjen ne dokumente ne kundershtim me Nenin 10 dhe 11 te LPP-se.

Pretendimi nr. 4

Për Lot 1 eshte rekomanduar OE R&Rukolli; SABA BELCA Dega në Kosovë ;ELMAZAJ KONSTRUKSION; Tekno-Konstrukt SH.P.K , OE eshte i pa pergjegjshem per faktin se :

Pavaresisht kohes se shkurter per kontrollimin e dokumentacionit te ketij OE te rekomanduar me Lot 1 , kemi verejtur shume mangesi ne Dosjen e te njejtit per cka I njejti do te duhej te shpallej I pa pergjegjshem dhe te eliminohet nga procedura e prokurimit., dhe jo te rekomandohet me kontrate.

4.1.OE eshte I pa pergjegjshem per faktin se ka deshtuar te plotesoje Kerkesen nr 7 te Dosjes se Tenderit qe te jete i Licencuar per prodhimin e Asfaltit .

Ku ka ofruar nje marreveshje bashkepunimi me SB Construction , ku ne Licencen e te njejtit shihet se e njejta ka skaduar me dt 18.04.2023 , perderisa ofertimi ne tender eshte bere me dt 04.05.2023 .

Prove e keni licencen e skaduar te te njejtit



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) me pajtim me nenin 6, 39, 40, 59 dhe 62 të Ligjit për Miniera dhe Minerale nr. 03/L-163 si dhe Ligjin nr. 04/L-158 Për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, në mbledhjen e mbajtur me datën 30/05/2018, bëri këtë:

Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale (NKRM) u skladu s članom 6, 39, 40, 59 i 62 Zakona o Rudnicima i Mineralima br. 03/L-163 kao i Zakona br. 04/L-158 za Promene i Dopune Zakona br. 03/L-163 za Rudnike i Minerale, na sednici održanoj na datumom 30/05/2018, donosi ovo:

Independent Commission for Mines and Minerals (ICMM) in accordance with article 6, 39, 40, 59 and 62 of the Law on Mines and Minerals no. 03/L-163 and the Law no. 04/L-158 on Amending and Supplementing the Law no. 03/L-163 on Mines and Minerals, in the meeting held on 30/05/2018, hereby issues this:

LEJE PËR AKTIVITETET E VEÇANTA
DOZVOLE ZA POSEBNE AKTIVNOSTI / SPECIAL OPERATIONS PERMIT
506/KPMM/2018

Emri i Biznesit / Naziv Biznisa / Name of Business:	"SR CONSTRUCTION" SHP.K.
Nr. i Biznesit / Br.Biznisa / Business No:	70127587
Nr. i Regjistrit / Br.Registratorija / Registration No:	873
Pronar i Biznesit / Vlasnik Biznisa / Business Owner:	Valon Elezaj
Kohëzgjatja / Trajanje / Duration: 10/04/2021	Sipërfaqja / Površina / Surface area: 10013.37 m²
Emri i vendit / Ime mesta / Site name: Allagorë	Leje për / Dozvola za / Permit for: baza e asfaltit / centrala za asfalt / asphalt base
Komuna / Opština / Municipality: Obilić	

Të drejtat dhe detyrimet / Prava i obaveze / Rights and obligations:

- Kompania obligohet që t'i plotësojë kushtet si bërësi i Lejës dhe obligimet si plotësuesi detyrimet sipas nenit 41 të Ligjit për Miniera dhe Minerale nr. 03/L-163 si dhe me Ligjin nr. 04/L-158 Për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale.
- Kompanija je dužna da se pridržava uslova ove Dozvole, i zadovlji se da ispuni svoje obaveze iz člana 41 Zakona o Rudnicima i Mineralima br. 03/L-163 kao i Zakona br. 04/L-158 za Promene i Dopune Zakona br. 03/L-163 za Rudnike i Minerale.
- Company is obliged to comply with the terms of this Permit and is obliged to fulfil its obligations under article 41 of the Law on Mines and Minerals no. 03/L-163 and the Law no 04/L-158 on Amending and Supplementing the Law no. 03/L-163 on Mines and Minerals.

Kryetari / Predsjednik / Chairman
Rasim QAJMAQI

Nr. Prot / Br. Prot / Prot. No: 4984
Datë / Datum / Date: 30.04.2018

.Pikerisht per mos plotesimin e nje kerkese te tille , Sallahu Shpk ishte eliminuar nga procedura e prokurimit te tenderi me titull ‘’ Sanimi I deformimeve te paraqitura ne rrugen Nacionale N2 perkatesisht ne rrugen lidhese te mbikalimi ne Babimost me numer prokurimi 205-21-5311-5-2-1, te dhena te cilat mund te verifikohen edhe nga e-prokurimi.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës/ Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastruc
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture

Letër standarde për tenderuesin e eliminuar

Prishtinë 20.10.2021

Operatori Ekonomik: "SALLAHU" SH.P.K., Rr.Baki Dullovi Nr.158, 71000, Kaçanik, Kosovë

Nr. i prokurimit:	MMPHI	2	1	0	4	0	5	2	1

Titulli: Sanimin e deformimeve të paraqitura në rrugën Nacionale N2 përkatësisht në rrugë lidhëse të Mbikalimi në Babimost

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, siç citohet në vazhdim "I indryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligji Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Operatori Ekonomik nuk i plotëson kriteret e përcaktuara ne Njoftimin për kontratë dhe do tenderit. Në dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne piken duhet te jete i licencuar leje per aktivitete te veqanta për prodhimin e bazës se asfaltit, prodhi bazës se betonit dhe OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes zhavorr. Dëshmia 8- Kopja e li lejesper aktivitete te veqanta të vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Mi Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marreveshja duhet te jete e noterizuar ne qiramarrësi dhe qiradhënësit. OE ka ofruar marrveshje bashkëpunimi me SA-SALLAHU SH licencat e asfaltit, betonit dhe gurëthyesit zhavorrit te cilat janë te skaduar me date:27.04.2021.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelu apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Auto Kontraktues në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Pub Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/ dhe Ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar ne Nenin I të këtij Njoftimi për dhë kontratës.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të va të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,
Nexhat Krasniqi

(Nënshkrimi)

Autoriteti Kontraktues ne refuzimin pretendimit ankimor ndaj ‘’ OE Rukollit ‘’ thote se :

‘’ OE ka prezantuar te gjitha deshmite apo marreveshje per furnizim qe kane te bejne me posedimin e lejeve per aktivitete te vecanta, por ne mungese te funksionimit te bordite qe bene leshimin e ketyre lejeve OE nuk ka mundur te bejne vazhdimin edhe pse kane bere kerkesa me kohe per vazhdimin e te njejtave ‘’

Por ky eshte konstatim krejtesisht I gabuar , sepse edhe ne si OE kur kemi ofertuat ne tenderin per te cilin jemi eliminuar per licencat , kemi pasur te dorezuara kerkesat per vazhdim sic kerkohet me Ligj per Miniera dhe Minerale 2 Muaj para skadimit, dhe po ashtu kemi percjellur te Zyra e Prokurimit edhe nje Njoftim shtese nga KPMM te dt 30.09.2023 ku madje ishte konstatuar se kerkesat per vazhdim jane dorezuar, se dokumentacioni eshte i kompletuar por bordi nuk ka qene funksional .

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals

DATË	**Prishtinë, 28.09.2021**
PËR	**Ndërmarrjen " Sa-Sallahu " sh.p.k- Rr. Baki Dullovi nr. 158 , Kaqanik**
NGA:	**Ramiz Krasniqi – Drejtor Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale**
LENDA:	**Përgjigjeje ne kërkesën tuaj numër 6330 data 27.09.2021**

I nderuar Z. Sallahu,

Komisioni i Pavarur për Minierat dhe Mineralet ka pranuar një kërkesë nga ndërmarrja "Sa-Sallahu" sh.p.k-Kaçanik, me nr. prot . 6330 data 27.09.2021, përmes së cilës ndërmarrja ka kërkuar nga KPMM –ja që të ju mundësohet lëshimi i një dokumenti "si dëshmi më rastin e ofertimit në tenderë", më arsyetimin se ndërmarrjes nuk i "ndërpritet operimi me prodhimin e bazës së asfaltit, betonit dhe zhavorrit", pasi që janë të kompletuar me dokumentacion për licencim.

Komisioni i caktuar me vendim të drejtorit e ka shqyrtuar kërkesën tuaj dhe në bazë të dhënave që kemi në KPMM e vërtetojmë se ndërmarrja "Sa-Sallahu" sh.p.k-Kaçanik ka pasur tri leje për aktivitet të veçanta të lëshuara nga KPMM-ja, të cilave iu ka skaduar afati i vlefshmërisë me datën 27.04.2021. Më datë 24.02.2021 , ndërmarrje ka aplikuar për vazhdimin të lejeve përmes kërkesave 1149,1150 dhe 1151. Andaj konstatojmë së kërkesat janë në procedurë të shqyrtimit dhe të njëjtat janë të kompletuara me dokumentacion, mirëpo ende nuk janë të aprovuara nga bordi i KPMM-së ngase Kuvendi i Republikës së Kosovës ende nuk e ka zgjedhur bordin e ri.

Shqyrtimi i aplikacioneve të parashtruara nga palët në KPMM- bëhet në pajtim me Ligji nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale.

Ligji nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale në nenin 59 paragrafi 1 përcakton se:

" ... Të gjitha kompetencat e KPMM ushtrohen nga Bordi. Çdo vendim i cili sipas këtij ligji kërkohet të merret nga KPMM duhet të merret nga vetë Bordi i KPMM."

Bazuar në sqarimet e më sipërme, ndërmarrja është e kompletuar me dokumentacion mirëpo pritet aprovimi nga Bordi për të u pajisur me leje për Aktivitete të veçanta.

Ramiz Krasniqi,
Drejtori
Komisioni i Pavarur për Minierat dhe Mineralet

DALJE
NR. PROT 3524
DATA 30.09.2021

Rr. Ammend Daci Nr.1
Prishtinë, Kosovë

Pergjigja e Autoritetit Kontraktues ka qene kjo (te cilen mund ta verifikoni edhe ne e-prokurim)

‘’Pas shkreseses se KPMMse te dt 30.09.2021 nuk konfirmohet se ju jeni te paisur me licencat e asfaltit,betonit dhe gurethyesit , apo qe ju mund te operoni deri ne vazhdimin e licneces se re, prandaj konsiderojme se ju nuk e keni plotesuar kushtin e Dosjes se Tenderit sipas Kerkesat mbi mundesite tekniike dhe/ose profesionale.

Andaj AK eshte I ndaluar qe te perdore standarde te dyfishta te vleresimit, dhe duhet t’a eliminoje njesoje edhe OE R&Rukolli; SABA BELCA Dega në Kosovë ;ELMAZAJ KONSTRUKSION; Tekno-Konstrukt SH.P.K

4.2.Edhe sa I perket kapacitetit Teknik dhe profesional , perkatesisht Inxhinereve ky OE I ka me mangesi dhe nuk I ploteson kerkesat e percaktuara ne DT dhe Njoftim per Kontrate .

P.sh Menaxher te projektit e ka ofruar Ragip Behrami ku I njejti nuk ka me nje kontrate valide per shkak se I ka skaduar me 31.12.2023 , por ajo se cfare e bene kete kontrate jo valide eshte edhe fakti se ne Kontrate Ref 01/2023 thuhet se e njejta u nenshkrua me date 03.01.2023 ne Skenderaj , te ciles I eshte bashkangjitur nje Vertetim neneshkrimi – Akt noterial I dates 18.04.2023 ku Noteri thote se ‘’ nenshkrim I I meposhtem eshte vene ne dokumentin privat te quajtur Kontrate pune per kohe te pa tacktuar , Ref H017/2023 e dt 01.01.2023 .

Pra shohim se kemi te bejme me dokument fiktiv , per faktin se nuk ka as datat e njejta dhe as nuk I referohet kontrates se njejt , por me numer referencash te ndryshme.

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuari, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:

Ref: 01/2023

KONTRATË PUNE
PËR KOHË TË CAKTUAR

(Vazhdim)

Neni 1

Me këtë Kontratë: **R&Rukolli SH.P.K.** me seli në Skenderaj, adresa Rr. 18 Qershori, me **Numër Unik Identifikues 810618366**, me pronar **z. Rrustem Rukolli** (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë kontratë pune me: **z. Ragip Behrami,** i lindur me 03.03.1980, me nr. personal **1008558244**, kualifikimi profesional **Inxhinier i Ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv**, adresa e vendbanimit lagja Arbëria Prishtinë, (në tekstin e mëtejshëm: I punësuari).

Neni 2

punësuari do të kryej këto detyra të punës:
Menaxher projektesh të ndryshme ndërtimi. *Detyrat dhe përgjegjësitë janë:*
PËRSHKRIMI I PROCESIT TË PUNËS – NIVELI III

1. **Detyrat dhe përgjegjësit për Pozitën Menaxher:**

- Drejton dhe menaxhon punishten sipas politikave të ndërmarrjes
- Përcakton prioritetet e punëve për punëtorët dhe punishtes, sipas rregullores së ndërmarrjes,
- Zbaton kërkesat që dalin nga dokumenti i vlerësimit të rrezikut dhe ndihmon në respektimin e tyre nga punëmarrësit,
- Ngarkohet do të Administroj një Baze Qendrore të Dhënash të Riskut. Ndihmon për organizimin e grupit të punës për vlerësimin e risqeve që krijohen nga rreziqet e zbuluara të raportuara dhe për miratimin e masave të duhura parandaluese dhe korrigjuese. Masat duhet të zbatohen në të gjitha vendet ose veprimtaritë e ngjashme të punës ku mund të ekzistojnë rreziqet.
- Ka përgjegjësi për të dhënë reagime tek punëmarrësit të cilët paraqesin gjetjen e një rreziku, duke trajtuar dhe japë informacionin mbi rreziqet.
- Ka përgjegjësi që të mbledhë informacion në lidhje me rreziqet i cili merret në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullave, për të vlerësuar risqet, të miratojë masa të përshtatshme dhe t'i zbatojë ato për të gjitha rastet e ngjashme.
- Informacioni i punonjësve duhet të ofrohet për të gjitha rreziqet dhe risqet përkatëse, si dhe informacioni për masat e marra në kohë të përshtatshme – në përputhje me urgjencën së informacionit ose veprimet e nevojshme. Kjo do të behet qysh nga dita e parë e fillimit të punimeve nga punëtor të rinjë dhe ata në proces pune.
- Projektimin i organizimit dhe dizajnimit të brendshme dhe të jashtëm sipas politikave të ndërmarrjes
- Mbikqyrja e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe analizimit i rreziqeve në hapësira dhe vende pune,
- Trajtimi dhe zgjidhja e problemëve gjatë fazave të operative të ndërmarrjes
- T'i planifikoj dhe organizoi:
- Radhitja e makinave sipas procesit të punimeve,
- Racionalizimi i mjeteve dhe i sendeve të punës,
- T'i verifikoj standardet e punës dhe cilësisë,

Neni 9

ë punësuarit i ndërpritet marrëdhënia e punës nga punëdhënësi, nëse:

1) ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;
2) i punësuari nuk është më i aftë të kryejë detyrat e punës;
3) në rastet e rënda të sjelljes së keqe të të punësuarit;
4) për shkak të mospërmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës, dhe
5) për rastet e tjera të cilat janë përcaktuar me Ligjin e Punës.

Neni 10

punësuari është i detyruar t'iu përmbahet masave të caktuara të mbrojtjes në punë.

Neni 11

Punëdhënësi dhe i punësuari i pranojnë të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e caktuara me këtë Kontratë.

Neni 12

Për kontestet eventuale të moszbatimit të kësaj Kontrate, palët kontraktuese e pranojnë kompetencën e Gjykatës Kompetente në Skenderaj.

Neni 13

Secila palë mund ta shkëpusë këtë Kontratë në mënyrë të njëanshme, sipas kushteve dhe rasteve të caktuara me Ligj.

Neni 14

Pas njoftimit me përmbajtjen e Kontratës, kjo Kontratë nga palët kontraktuese u nënshkrua më datën: 03.01.2023, në Skenderaj, në dy (2) kopje autentike, nga të cilat, secilës palë i mbetet nga një kopje.

Punëdhënësi:
R&Rukolli SH.P.K.

Ndërmarrja Ndërtimore R & Rukolli SH.P.K. Construction Company

I Punësuari:
Ragip Behrami

Republika e Kosovës
NOTER
ZYFER ALIU
LIPJAN

LRP.4885/2023

----------Vërtetim nënshkrimi----------

Sot, më date **18.04.2023**(tetëmbëdhjetë prill dymijë e njëzet e tre) para meje, Zyfer Aliu, Noter me seli në Lipjan ,Rruga" Lidhja e Prizrenit" p.n , vërteton se:----------

Nënshkrimi i mëposhtëm i vënë në dokumentin privat të quajtur **"Kontratë pune për kohë te caktuar"** , Ref.:H017/2023 e dt.01.01.2023 është vënë nga:----------

1.Z.Agim Rukolli, i lindur në F.Rezallë-Skenderaj , më **23.07.1986**(njëzet e tre korrik njëmijë e nëntëqind e tetëdhjet e gjashtë) ,me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, shtetas i Republikës së Kosovës, identiteti i të cilit konstatohet nga letërnjoftimit me nr personal **1172382769** i lëshuar nga MPB Prishtinë më dt. 09.02.2022 valid gjerë më 08.02.2032, madhorë me zotësi të plotë veprimi(Përfaqësuesi i **"R&Rukolli " sh.p.k**).----------

2.Z.Ragip Behrami i lindur në Skenderaj , më **03.03.1980**(tre mars njëmijë e nëntëqind e tetëdhjet ,me vendbanim të përhershëm në Skenderaj, shtetas i Republikës së Kosovës, identiteti i tij konstatohet nga letërnjoftimit me nr personal **1008558244** i lëshuar nga MPB Prishtinë me dt 19.09.2019 valid gjerë më 18.09.2029, madhorë me zotësi të plotë veprimi.----------

Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e dokumentit të përpiluar jashtë zyrës së tij, noteri vetem vërteton nënshkrimin e palës të vënë në praninë e tij dhe në zyrën e tij ----------

Ky akt është paguar sipas UA mbi Tarifat noteriale me nr. 05/2022 , neni 31.1 dhe 2 për çdo nënshkrim 1€ për persona fizik dhe 2€ për persona juridik=6 nënshkrime = 9€+1€ për vendosjen e vinjetës (Neni 42.2 i TN-së)=10+18%TVSH=11.80€ (njëmbëdhjetë e tetë 80/100).----------

Veprimi i noterizimit u krye në Lipjan, më dt.18.04.2023(tetëmbëdhjetë prill dymijë e njëzet e tre) në selin e Noterit Zyfer Aliu në adresën e lartshënuar.----------

NOTER
Zyfer Aliu

4.3.Se I njejti ka paraqitur dokumente fiktive e deshmon edhe fakti se ka prezantuar veprime te tilla te kontratave psh ing Avdi Citaku , ku kontrata thuhet se eshte nenshkruar

me 04.01.2023 , ndersa vertetim nenshkrimi I aktit notarial eshte I dates 20.04.2023.

Neni 8

I punësuari është përgjegjës për kompensimin e dëmit për punën ose në lidhje me punën, nëse me qëllim ose nga pakujdesia i ka shkaktuar dëm punëdhënësit.

I punësuari është përgjegjës edhe për shfrytëzimin e mjeteve ose asketëve të ndërmarrjes pa autorizim paraprak të punëdhënësit, keqpërdorimit të emrit apo logos së ndërmarrjes si dhe për shpalosjen apo mos konfidencialitetin e nevojshëm në përputhje me rregullat e brendshme të ndërmarrjes.

I punësuari është përgjegjës edhe për kompensimin e dëmit, nëse me fajin e tij i ka shkaktuar dëm palës së tretë, dëm për të cilin punëdhënësi e ka kompensuar të dëmtuarin.

Neni 9

Të punësuarit i ndërpritet marrëdhënia e punës nga punëdhënësi, nëse:

1) ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;
2) i punësuari nuk është më i aftë të kryejë detyrat e punës;
3) në rastet e rënda të sjelljes së keqe të të punësuarit;
4) për shkak të mospërmbushjes së kënaqshme të detyrave të punës, dhe
5) për rastet e tjera të cilat janë përcaktuar me Ligjin e Punës.

Neni 10

I punësuari është i detyruar t'iu përmbahet masave të caktuara të mbrojtjes në punë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË PUNËS – NIVELI III

Detyrat dhe përgjegjësit për Pozitën Menaxher/ Inxhinier:

- Drejton dhe menaxhon Njësinë Punuese sipas rregullave të SSHP-së dhe politikave të kompanisë;
- Punëtoret e pranuar për herë të parë i paraqet në administratë për lidhje kontrate, paraqesin Certifikatën e mjekut se është i aftë për punë, pastaj vazhdon trajnimin lidhje me SSHP, pajisen me udhëzime të nevojshme lidhje me sigurinë teknike, PPM dhe fillon me punimet sipas kontratës;
- Përcakton prioritetet e punëve për punëmarrësit sipas rregullores së kompanisë;
- Zbaton kërkesat që dalin nga dokumenti i vlerësimit të rrezikut dhe ndihmon në respektimin e tyre nga punëmarrësit;
- Ngarkohet që të Administroj një Bazë Qendrore të Dhënash të Riskut. Ndihmon për organizimin e grupit të punës për vlerësimin e risqeve që krijohen nga rreziqet e zbuluara të raportuara dhe për miratimin e masave të duhura parandaluese dhe korrigjuese. Masat duhet të zbatohen në të gjitha vendet ose veprimtaritë e ngjashme të punës ku mund të ekzistojnë rreziqet;

Neni 11

[illegible]ëdhënësi dhe i punësuari i pranojnë të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e caktuara me këtë Kontratë.

Neni 12

[illegible]kontestet eventuale të moszbatimit të kësaj Kontrate, palët kontraktuese e pranojnë kompetencën e Gjykatës Kompetente [illegible]kenderaj.

Neni 13

[illegible]a palë mund ta shkëpusë këtë Kontratë në mënyrë të njëanshme, sipas kushteve dhe rasteve të caktuara me Ligj.

Neni 14

[illegible]joftimit me përmbajtjen e Kontratës, kjo Kontratë nga palët kontraktuese u nënshkrua më datën: 04.01.2023, në [illegible]eraj, në dy (2) kopje autentike, nga të cilat, secilës palë i mbetet nga një kopje.

[illegible]hënësi:
[illegible]ukolli SH.P.K.
[illegible]Behrami – drejtor teknik

I Punësuari:
Avdi Çitaku

Ndërmarrja Ndërtimore R & Rukolli SH.P.K. Construction Company

REPUBLIKA E KOSOVËS
NOTER
ZYFER ALIU
LIPJAN

LRP.Nr.5376/2023

----------Vërtetim nënshkrimi----------

Sot, më datë **20.04.2023** (njëzetë prill dymijë e njëzet e tre) para meje, Zyfer Aliu, Noter me seli në Lipjan, Rruga "Lidhja e Prizrenit" nr.159 , vërteton se:----------

Nënshkrimi i mëposhtëm i vënë në dokumentin privat të quajtur " **Kontratë pune për kohë të caktuar**", është vënë nga:----------

